



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**V E N D I M**

Nr. 04, datë 01.12.2015

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “GODINË SHËRBIMI 1 KAT”,  
RINAS, BASHKIA KRUIË**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e subjektit kërkues, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Godinë Shërbimi 1 Kat”, Rinas, Bashkia Krujë, me subjekt kërkues shoqërinë “Albcontrol” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) pajisjes me dokumentin përkatës mjedisor;
  - b) nënshkrimit të kontratës me Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik (ASHA) për mbikëqyrjen arkeologjike gjatë ndërtimit;
  - c) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



**ZËVENDËS KRYETAR I KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



**SEKRETAR I KKT**

**LEDIA TOTA**



**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**